

**Dr. Tony B. Watlington Sr., Ed.D.**  
Superintendent

12 Korrik, 2022

Përshëndetje Familje të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias,

Sot kam kënaqësinë të njoftoj nisjen zyrtare të Ekipit tim të Tranzicionit. Siç e dini, prioritetet e mia kryesore janë përmirësimi i rezultateve të studentëve dhe arritja [e Qëllimeve dhe Objektivave të Bordit](#). Nisja e këtij ekipi është faza e dytë e qasjes sime trefazore për të hedhur një themel të fortë për arritjen e këtyre prioritetëve. Faza e parë, dëgjimi dhe mësimi, është duke ecur mirë. Unë jam mirënjohës për gjithçka që kam mësuar deri më tani dhe pres me padurim bisedën e vazhdueshme. Jam i emocionuar për mënyrat se si turneu i dëgjimit dhe mësimi, dhe puna e Ekipit të Tranzicionit, do të informojnë fazën e tretë – një plan të ri strategjik për Drejtorinë Arsimore të Filadelfias.

Ekipi i Tranzicionit do të bashkëkryesohet nga dy udhëheqës të respektuar të Filadelfias – Andrea Custis, President dhe CEO i Lidhjes Urbane të Filadelfias dhe Dr. Guy Generalis, President i Kolegjit Komunitar të Filadelfias.

Nëpërmjet këtij ekipi, unë po sjell qëllimisht më shumë se 80 anëtarë të komunitetit të Filadelfias - duke përfshirë prindërit, mësuesit, drejtorët, sindikatat, arsimin, qytetin, biznesin, dhe drejtuesit e bazës dhe personelin e SDP-së - së bashku dhe liderët e industrisë për t'u mbledhur në pesë nënkomisione:

1. Arritja e Studentit
2. Operacionet
3. Kultura Anti-Raciste e Drejtorisë
4. Angazhimi dhe Komunikimi
5. Përvoja dhe Experienca e Mirë e Shkollave

Këto nënkomitete do të sjellin njohuri, përvoja dhe të dhëna lokale së bashku me kërkimin arsimor dhe praktikën më të mira afatshkurtër dhe afatgjatë për përparim në fushat e tyre të përqendrimit/vëmendjes. Këto rekomandime do t'i paraqiten Bordit dhe publikut në vjeshtë.

Jam i emocionuar për punën e mirë që është duke u zhvilluar dhe për punën në horizont drejt qëllimit tonë kolektiv për të përmirësuar rezultatet për të gjithë nxënësit tanë. Mund të mësoni më shumë rreth punës dhe të takoni Ekipin e Tranzicionit në [: 100-Days website](#).

Në partneritet për fëmijët,

*Tony*

Tony B. Watlington Sr., Ed.D.

Superintendent

Drejtoria Arsimore e Filadelfias